



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

**PËR DHËNIE AUTORIZIMI PËR NDRYSHIMIN E VENDNDODHJES TË DISA QV-VE,
PËR ZGJEDHJET PËR ORGNET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR
2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 12.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI -	Anëtar
Edlira	JORGAQI -	Anëtare
Rezarta	BITRI -	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 62, pika 4, neni 93, pika 2, gërma "a", të Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

V E R E N

Kryetari i Bashkisë Durrës me shkresën nr. 2739 prot., datë 07.05.2019, ka kërkuar dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjeve të 6 QV-ve si më poshtë:

- QV nr.1412, QV nr.1412/1, QV nr.1412/2, QV nr. 1412/3, QV nr. 1515, QV nr. 1516:



Dhënia e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjeve të katër QV, të caktuara në "Ambulanca Plazh", kërkohet pasi në to janë të rregjistruar numër i konsiderueshëm zgjedhësish dhe gjithashtu keto ambiente janë në shërbim 24 orë të banorëve dhe pushuesve, gjatë sezonit veror.

Dhënia e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjeve të dy QV të caktuara në Shkollën "Qerret", kërkohet pasi ky objekt është në rikonstrukcion.

Kryetari i Bashkisë Shijak me shkresën nr. 2625 prot., datë 02.05.2019, ka kërkuar dhënien e autorizimit për ndryshimin e një qendre votimi:

- QV nr. 1337, Kopshti Bilalas, Bashkia Shijak.

Dhënia e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes të QV, të caktuar në Kopshtin e fëmijëve, kërkohet pasi objekti është shembur dhe si pasojë nuk mund të shërbejë si vendndodhje e kësaj qendre votimi.

Kryetari i Bashkisë Divjakë me shkresën nr. 11147 prot., datë 10.06.2019, ka kërkuar dhënien e autorizimit për ndryshimin e një qendre votimi:

- QV nr. 2955, Qendra Shëndetsore Këmishtaj, Bashkia Divjakë.

Dhënia e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes të QV të caktuar në Qendrën Shëndetsore, Këmishtaj kërkohet pasi objekti është në gjendje të amortizuar dhe nuk mund të shërbejë si vendndodhje e qendrës së votimit.

Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë me shkresën nr. 2375/1 prot., datë 12.06.2019, ka kërkuar dhënien e autorizimit për ndryshimin e një qendre votimi:

- QV nr. 4241, Shkolla "Bajo Topulli", Bashkia Gjirokastrë.

Dhënia e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes të QV, të caktuar në Shkollën "Bajo Topulli", kërkohet pasi objekti është rrënuar, nuk ka mundësi riparimi dhe nuk mund të shërbejë si vendndodhje e qendrës së votimit.

Kryetari i Bashkisë Sarandë me shkresën nr. 11131 prot., datë 10.06.2019, ka kërkuar dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjeve të 4 QV-ve si më poshtë:

- QV nr.4663, lokal Bistrica, Bashkia Sarandë,
- QV nr.4672/1, lokal privat Orest Lepuri, Bashkia Sarandë,
- QV nr.4672/2, lokal privat Fiqiri Laze, Bashkia Sarandë,
- QV nr. 4673/1, lokal privat Halim Bani, Bashkia Sarandë.

Dhënia e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjeve të katër QV-ve, kërkohet pasi pronarët kanë ndryshuar llojin e aktivitetit, si pasojë bëhet e pamundur funksionimi i ambienteve si qendra votimi.



PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", nenin 62, pika 4, neni 93, pika 2, gërma "a", të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

V E N D O S I :

1. Dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjeve të QV-ve sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Kryetari i Bashkisë të publikojë menjëherë listat e zgjedhësve në vendndodhjet e qendrave të votimit, caktuar me këtë vendim.
3. Kryetari i Njesisë së Qeverisjes Vendore të njoftojë menjëherë zgjedhësit, për vendndodhjen e qendrës së votimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

